

## Qeraja Financiare për Biznes (Leasing)

Qeraja financiare ose siç njihet gjerësisht leasing, është një nga mënyrat më efektive të financimit të blerjes së aseteve në përdorim nga kompania.

Leasing është një proces ku qiramarrësi, në këtë rast biznesi i vogël, ka në përdorim një aset, që është edhe objekti i kontratës leasing, për të cilin kryen një seri pagesash periodike deri në shlyerjen e gjithë vlerës së këtij asemi. Deri në përfundim të këtyre pagesave, prona e asetit mbetet tek qeradhënësi.

Asetet objekt financimi mund të jenë:

- Mjete motorike: Makina / Flotë / Furgonë / SPV / Kamion / Autobus, etj
- Pajisje dhe makineri: Pajisje mjekësore, Printimi, IT, Telekomunikimi, Ndërtimi, etj

Avantazhet e leasing në krahasim me kredinë lidhen kryesisht me:

- Terma më të mira financimi (norma interesi, afat, parapagim, vlera e mbetur)
- Nuk kërkohet kolateral shtesë, pasi objekti i leasing shërben si kolateral
- Shpenzimet mujore janë 100% të zbritshme për efekt tatimor
- Mundësia për të amortizuar një aset pa e paguar plotësisht që në fillim

### **Financim deri në 90% të vlerës së blerjes së asetit.**

- Plan amortizimi i kredisë i përshtatur sipas sezonalitetit të biznesit.
- Kohëzgjatja: deri në 7 vjet;
- Për financimet deri në 50,000 Euro merret përgjigje brenda 24 orësh.
- Pa kolateral shtesë
- Dokumentat bazë të biznesit